

URDHËR
Nr. 1498, datë 4.9.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; të nenit 73/2 të Rregullave të Prokurimit Publik, miratuar me vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave lidhur me ushtrimin e përgjegjësi të titullarit të Autoritetit Kontraktor për procedurat e prokurimit “Blerje me vlera të vogla” dhe “Blerje nëpërmjet sistemit dinamik të biletave të transportit ajror”, në cilësinë e zyrtarit të autorizuar, zotit Ylli Imeri, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga zyrtari i autorizuar me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

3. Zyrtari i autorizuar raporton periodikisht çdo katër muaj, pranë organit delegues mbi përmbushjen e detyrave/përgjegjësi të deleguara.

4. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri zyrtari i autorizuar dhe çdo strukturë përgjegjëse për procedurat e prokurimit si më sipër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Piro Vengu